



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.983/22

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Skender Çoçaj anëtarë, me praktikanten gjyqësore Blerta Thaçi, si procesmbajtëse në lëndën penale ndaj të akuzuarit E.S. nga Mitrovica, për shkak të vepres penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr. 803/2021 të datës 18.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17 janar 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së të akuzuarit E.S. **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.803/2021 i datës 18.05.2022 përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit E.S. për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së për të cilën është shpallur fajtor, dënimin e shqiptuar me burgim efektiv në kohezgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i'a shëndrrohet në dënim burgimi të kushtëzuar e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej (1) viti pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi nuk kryen tjetër veprë penale. Dënimi i shqiptuar me gjobe në shumë prej 500 (pesëqind) euro vertetohet, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaje në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti zëvendësohet në dënim me burgim ku për çdo 20 euro të gjobes do të llogaritet 1 ditë burgim.

Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr. 803/2021 të datës 08.05.2022, i akuzuari E.S. është shpallur fajtor për shkak të vepres penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohezgjatje prej 6 (gjashtë) muaj si dhe dënimi me gjobe në

shume prej 500 (peseqind) euro, e i cili denim do te ekzekutohej ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se aktgjykimit.

Nga i akuzuari eshte konfiskuar substanca narkotike e cila permban Tetrahidrokanabinol, ne peshe prej 0.24 gram.

I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale qe dalin sipas llogarise perfundimtare te gjykates, ne emer te paushallit gjyqësor në shumë prej 20 (njezet) Euro dhe shumë prej 30 (tridhjetë) Euro në emër të fondit për kompenzimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

I akuzuari E.S. nga Mitrovica, per shkak te vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe Gjykata e Apelit e Kosoves, aktgjykimin e ankimuar te Gjykates se shkalles se parë ta ndryshoje dhe te akuzuarit te i shqiptoje nje denim me te bute se sa denimi i shqiptuar nga ana e gjykates se shkalles se pare.

Prokurori i Apelit i Kosovës duke u deklaruar përkitazi me ankesen e te akuzuarit, me shkresën e tij PPA/II.nr.1021/22 të datës 18.07.2022 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesen e te akuzuarit ta refuzoje si të pabazuar, ndersa aktgjykimin e ankimuar te gjykates se shkalles se pare ta vertetoje.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës mbajti seancën konform nenit 390 par.1 të KPPRK-së, në të cilën prezantoi vetëm mbrojtësi me autorizim i të akuzuarit E.S. – av Xhelal Hasani nga Mitrovica ndërsa munguan Prokurori i Apelit si dhe i akuzuari E.S. për të cilin mbrojtësi i tij deklaroi se i njëjti është i njoftuar lidhur me seancën mirëpo gjendet jashtë shtetit, andaj seanca u mbajt në pajtim me nenin 390 par 4 të KPPRK-së. Mbrojtësi i të akuzuarit në tërësi mbeti pranë ankesës së ushtruar nga ana e e të akuzuarit dhe propozoi që e njëjta të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit të i shqiptohet një dënim me burgim të kushtëzuar i cili do të ishte adekuat me peshën e veprës penale të kryer e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit e sidomos nga fakti se i akuzuari në ndërkohë është punësuar dhe se shkuarja e tij në ekzekutim të dënimit do të ndikonte që ta humb punën.

Gjykata e Apelit e Kosovës konform nenit 394 par.1 të KPRK-së, shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te te akuzuarit dhe gjeti se:

- Ankesa eshte pjesërisht është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 15.04.2022 në bazë të nenit 248 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, i akuzuarit me ankesë pretendon që dënimi i shqiptuar me burgim efektiv në kohezagjatje prej 6 (gjashtë) muaj si dhe denimi me gjobe në shume prej 500 (peseqind) euro, janë të larta duke patur parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, ka shprehur pendim të thellë për veprën penale të kryer dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, pastaj se është i gjendjes e vështire ekonomike dhe se shkuarja në burg do të kishte pasoja për familjen e tij, andaj ka propozuar që të i shqiptohet një dënim me i ulët respektivisht dënim me burgim të kushtezuar e me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së si dhe të i mundesohet pagesa e gjobes me keste.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit e Kosovës vlerësoi se pretendimet ankimore të akuzuarit lidhur me vendimin mbi sanksionin penal janë pjesërisht të bazuara e sidomos edhe nga fakti se mbrojtësi i tij avokati Xhelal Hasani në seancën para Gjykatës së Apelit deklaroi se i akuzuari tani është i punësuar dhe se shkuarja e të njëjtit në burg do të kishte pasoja për të dhe familjen dhe propozoi që të njëjtit të i shqiptohet dënim me burgim të kushtezuar e gjithashtu edhe duke patur edhe parasysh sasinë e vogël të narkotikut, andaj Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dënimin e shqiptuar me burgim efektiv i'a shëndrroi në dënim burgimi të kushtezuar ndërsa dënimin me gjobe e vërtetoi me bindje se dënimi i ndryshuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer dhe se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 983/22 më 17.01.2023

Procesmbajtëse
Blerta Thaçi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit,
Beqir Kalludra

Skender Çoçaj
